

**“GRUAJA E FOTOGRAFIT”**

**tregim**

**nga**

**Enkelejd Lamaj**

“Është historia, jo ai që e tregon.”

STEPHEN KING

ÇDO QYTEZË SHQIPTARE (ashtu si çdo e tillë në botë, mendoj) ka historitë e veta. E, në çdo qytezë të vogël shqiptare, sado e vogël që të jetë një histori që ndodh, është e sigurt që do i hyjë në xhep dikujt, ose *disave*. Në shumë raste i hyn në xhep gjithkujt, e për sa u përket atyre që nuk u hyn në xhep, duan apo nuk duan, do të dëgjojnë, sepse nuk kanë se çfarë të bëjnë tjetër e do të ndërhyjnë edhe me mendimet e tyre, ashtu kot, sa për të mos dalë nga tufa. Përndryshe i quajnë të marrë.

Historia e gruas së fotografit (edhe pse, të thuash të drejtën, dikur ka bërë pjesë në kategorinë e Historive-Që-I-Hyn-Në-Xhep-Gjithkujt) po të vish në Drelan të Lushnjes, vështirë se do ta dëgjosh. Në fakt, ajo, tashmë, nuk konsiderohet më si e tillë. Dua të them se drelanotët nuk e llogarisin më fare e, në qoftë se i pyet, gjithçka mund të ta përfshijnë pak a shumë me këto fjalë: «Gruaja e fotografit, që thoni ju, u mërzit me gjërat e vogla të të shoqit dhe vendosi të gjente një dashnor që të mos kishte gjëra të vogla, mbas të cilit u dashurua me aq shumë zell, saqë, një ditë (teksa ishte duke shkuar tek ai me makinën që ia kishte dhuruar vetë fotografi) mori flakë: me aq shumë zjarr e dashuronte!» E në fund, sa për një ndryshim të vogël - thjesht si një atribut i vogël për nder të vendit që ka zënë dikur – shtojnë: «Unë s’isha duke kaluar vetë aty, por mjeku që i bëri ekspertizën mjekësore, domethënë autopsinë, tha se burimi *i vërtetë* flakës që e përpiu ka qenë... zëmra e saj.» E

pastaj do të kalohet tek ndonjë histori më shumë *e dukshme*, si për shembull ajo e shtëpisë me numër 13 në rrugën Ludizia, apo ajo qenit që u hakmor ndaj të zotit – një magazinieri – i cili, gabimisht, e kishte varrosur të gjallë.

Por mua, ‘historia e gruas së fotografit’ është një histori e cila më pëlqen dhe kur kam rast, e tregoj. Në fakt, më pëlqente më shumë kur e dëgjoja nga protagonisti në fjalë. ‘Historia e gruas së fotografit’ është termi që përdorin të gjithë (ato pak herë që e përdorin), por në të vërtetë ajo është edhe historia e vetë fotografit, ose më saktë është historia e teorisë së tij mbi rëndësinë e gjërave të vogla dhe është pikërisht për këtë të fundit që mua më pëlqen dhe, me vetëdije, e fus në dosjen e Historive-Që-Ia-Vlejnë.

Sotir Muzaka nuk ishte një prej miqve të mi më të mirë, por ishte një shok. Dhe ishte edhe i mirë. Reshti se praktikuari profesionin e fotografit të njëjtin muaj të zhdukjes së të shoqes, por përsëri, në ditën e parë të vitit, për pesë vite rresht, vazhdoi të trokiste rregullisht në derën e shtëpisë sime dhe, mbasi na priste me durim që të visheshim, na bënte fotografinë e zakonshme. Dhe na e bënte *falas*. Të them se nuk e di se edhe sa të tjerëve ua bënte këtë gjë, do gënjeja, por kjo nuk ka lidhje me historinë e sotme, ndaj dhe lejomëni ta anashkaloj.

Dikur, kur koha ishte më e butë dhe më e re dhe ne kishim më shumë gjak se sa ilaçe të holluara që na rridhte nëpër vena, unë e Sotiri shkonim të luanim bilardo tek Gaqua. Beh, tek e fundit ishim komshinj, nuk kishte asgjë të keqe. Tek Gaqua shkonin pothuajse të gjithë, aso kohe: atë kishim laj – thaj. Shkonim vetëm të shtunave, ditët e tjera unë punoja në fabrikë, kurse ai ishte gjithmonë në qoskën e tij të vogël përballë kinemasë. Por, një vit, edhe ai rit i vogël i yni u ndërpre kështu, pa pritur e papandehur. Nuk e di, të them të drejtën, se kur filloi të rrallohej, *në qoftë se* filloi të rrallohej ndonjëherë e nuk u ndërpre tak-fak, siç pritet një kabëll tensioni i lartë që të lë pastaj pa dritë. Kujtesa ime është aq e aftë sa të më thotë se një të shtunë u gjenda në verandën e shtëpisë sime dhe e kuptova se atë moment duhej të isha duke luajtur bilardo me Sotirin, por ja që isha aty, duke rrahur kofshën me gishtat e dorës, ulur në karrigen time të vjetër, duke pritur perëndimin e diellit e duke u mundur të gjeja se sa të shtuna të tjera kisha kaluar ashtu, se kur kishte qenë e shtuna e fundit që kisha shkuar të luaja bilardo me Sotirin.

Një vit më parë kishin ndodhur dy gjëra njëkohësisht: 1) Gaqo Buda që kishte bilardon u gjend i therur brenda bilardos së tij dhe 2) Sajmira Muzaka u nis një ditë për diku e nuk u

kthye më. Në qoftë se ju intereson, unë preferoj të mendoj që arsyeja që provokoi ndërprerjen e lojërave të mia me Sotirin, ishte vrasja e Gaqos dhe mbyllja e bilardos.

Unë vazhdova të takohesha me Sotirin, natyrisht, edhe pse më rrallë. Nuk shkonim më për të luajtur, as nuk shkonim gjëkund për të pirë. Por, herë pas here, thjesht uleshim në verandën e shtëpisë sime dhe aty kalonim pasditen, sigurisht, kur koha ishte e bukur dhe kur nuk binte shi. E edhe pinim. Natasha ime na përgatiste një pjatë me turshi të bëra nga vetë ajo, pak djathë dhe dy gota. Kurse me rakinë merresha vetë. Im atë, rahmet pastë, më ka lënë në trashëgim – midis shumë të tjerave – edhe dy thënie, që për mua janë të mëdha. E para thotë se kurrë nuk duhet të vësh dorën në zjarr për asgjë e për asnjë, madje as për veten tënde. Kurse e dyta ka të bëjë me ‘ujin e bekuar’: im atë ka qenë një konsumator i atillë i rakisë saqë kur çahet, nuk i dilte gjak, por ‘ujë i bekuar’. Rakia më e mirë, thoshte, është ajo që kalon vetëm nëpër duar burrash. “Uji i bekuar” që shërbehet nga një *Evë* e humbet bekimin e ngelet vetëm ujë. Kam hedhur mbas shpine plot shtatëdhjetë pranvera dhe qendra e komandave atje lart në majë të kullës nuk është më si dikur, ka *çyçyvera* që kanë nevojë për ndonjë ndërhyrje teknike, apo ndonjë pastrim të mirë, e megjithatë këto dy gjëra i mbaj mend shumë mirë.

«Është e çuditshme se si njeriu mban mend disa gjëra dhe harron disa të tjera», thoshte edhe Sotiri herë pas here.

Mua, personalisht, çdo herë ai thoshte këtë gjë, më vinte ndër mend që nuk arrija të kujtoja se kur kishte qenë hera e fundit që unë e Sotiri kishim luajtur bilardo. Natyrisht, Sotiri, ato çaste mendonte tjetër gjë. Personalisht, nuk e di se sa shumë i pëlqente atij, por di që shpesh herë fliste. Tregonte. Historinë e gruas së tij, e kam fjalën, historinë e tij, historinë e rëndësisë së gjërave të vogla. Kur kishte mundësi, tregonte. Unë, nuk e di se sa i aftë do të isha të tregoja e të stërtregoja se si një ditë, gruaja ima mori makinën dhe rendi tek dashnori i saj. Natasha ime mendon se edhe unë do të isha i aftë të tregoja, kurse unë vetë, kam përshtypjen se më i aftë do isha ta ndiqja nga pas me idenë për t’iu futur nga një plumb mu në lule të ballit, sesa të tregoja.

«E di çfarë?» thoshte Sotiri. «Të flasësh, të ndihmon të mos harrosh.»

Natasha ime dhe Sajmira e Sotirit, kur ajo ishte ende mes nesh, shkonin po aq sa shkonin edhe burrat e tyre. Natyrisht, ato nuk takoheshin çdo të shtunë për të shkuar në bilardo, por takoheshin çdo herë të kishin mundësi e pinin ndonjë kafe dhe merreshin me thashethemet e

tyre të zakonshme. Kur Sajmira u zhduk, Natasha u bë keq. Kur Sajmira u zhduk, keq u bë edhe Merjemja në anën tjetër të rrugës, por, duke dashur të përdor fjalët e sime shoqeje, në qoftë se “ajo andej” u bë keq sepse *nuk* kishte mundur të dyshonte gjë, Natasha u bë sepse ajo *kishte* dyshuar diçka. Këtë dhe dyshimet e veta, m’i tha të njëjtën ditë të zhdukjes së saj.

«Edhe ne zihemi ndonjëherë», i bëra të ditur unë. «Kjo s’do të thotë gjë.»

«Po, por ata zihen... *ziheshin* përditë, ama. *Përditë.*»

«S’e di. Unë për vete nuk kam vënë re gjë.»

Natyrisht nuk e kisha fjalën për zënkat e tyre. Që Sotiri mund të zihej me Sajmirën, këtë e kisha dyshuar edhe unë, ose më mirë të them e dija. Të shtunave, ndodhte që ai të bënte çmos të luanim edhe një lojë më shumë, *hë* edhe një lojë më shumë, *të lutem* edhe një lojë më shumë. Mbas pak, e kuptova që nuk bëhej fjalë sepse atij i interesonte më shumë revanshi që i duhej të merrte ndaj meje. Gjatë asaj periudhe, Sotiri, gjithsesi, nuk foli në lidhje me problemet e tij. Këtë gjë e bëri më vonë, mbas zhdukjes së Sajmirës. Unë thjesht mblodha dy edhe dy.

«Ajo mungonte shumë gjatë ditës. Ndonjëherë ikte në mëngjes e kthehej në drekë. Kur Sotiri i bleu edhe makinën pastaj, vinte vetëm në darkë.»

Unë ia ktheva sime shoqeje që *as kjo* nuk tregonte gjë dhe ajo më tha se do ta shihja vetë. E në fakt, tre javë më vonë, Sotiri erdhi në verandën time dhe disa orë mbas përdimit të diellit, unë dëgjova, për herë të parë, historinë e vërtetë të gruas së tij, apo është më mirë të them *versionin* e tij? Që atëherë e kam dëgjuar kush e di edhe sa herë të tjera: ish-fotografi i qytezës e tregonte pothuajse çdo herë që vinte tek unë. Unë nuk mërzhitesha dhe e dëgjoja me durim, çdo herë si të ishte hera e parë. Tek e fundit, ai vinte shumë rrallë tani tek unë dhe, përveç kësaj, unë e dija që të treguarit e ndihmonte që të mos harronte.

Nuk kishte rëndësi se çfarë ishte duke biseduar ato momente: ishte duke folur për tollonat e dikurshëm, apo për depot e armëve, vinte një moment që Sotiri bëhej i mendueshëm dhe ti kapje veten gafil duke iu përgjigjur vetë pyetjeve që i kishe drejtuar atij. Sotiri ishte mjaft diplomatik, nga kjo anë: ndoshta, ndonjë tjetër do të të ndërpriste fjalën në mes e do të fillonte të thoshte atë që kishte ndër mend, por jo Sotiri. Ai priste me durim. Merrte gotën e rakisë në dorë (e mbushte nëse e kishte përgjysmë), pinte dhe vazhdonte ta mbante në dorë. Ti flisje. Ai zgjatej dhe merrte një copë turshi dhe e fuste në gojë, pastaj merrte një copë djathi dhe e fuste edhe atë në gojë. Lëshonte kështu trupin mbas mbështetëses dhe përtypej

ngadalë, me gotën e rakisë që mbështeste mbi gju. Priste. Ajo që kishte për të thënë nuk ishte e rëndomtë si muhabeti që ishte duke u bërë në atë tavolinë. Donte durim. Ndaj dhe priste. Gjersa ti të kuptoje se kishte ardhur momenti. Atëherë *ti* heshtje. Kontrollonje gotën e rakisë dhe në qoftë se e kishe përgjysmë, e ktheje me fund, pastaj e mbushje me majë dhe prisje.

Unë, gjithmonë e kisha kuptuar se *kur* vinte çasti që Sotiri do zinte të tregonte: ajo ç'ka s'munda të kuptoj dot, ishte se *çfarë* e sillte atë moment, cili ishte çelësi që e ndizte, cila ishte shkëndija që e provokonte dhe pse pikërisht në atë moment. Me gjithë përpjekjet e imagjinatës sime, këto pyetje kanë mbetur pa përgjigje, ndaj dhe s'mund t'ju them gjë.

Por mund t'ju them, që kur momenti vinte, Sotiri psherëtinte. Vetëm një herë. Thellë. Linte gotën mbi tavolinë dhe: «T'ëmën, e s'ëmës, Dalip», thoshte pastaj. «Sot janë bërë plot 2 vjet e katër muaj e shtatë ditë që Sa-e-mira s'është më.»

Kështu e thërriste gjithmonë ai: jo Sajmira, por Sa-e-mira. (Ah, e di që e kuptuat vetë, por duke sjellë ndër mend shprehjen e parë të tim ati, ramet pastë, më duhet të them se ajo '2 vjet e katër muaj e shtatë ditë' është pjesë e ndryshueshme. Normale, ëh!)

«E, nëse ndihem mirë, apo nëse ndihem keq, nuk e di.» Vazhdonte Sotiri dhe mbas një heshtje të shkurtër shtonte: «Ende.»

Pastaj merrte gotën e rakisë, pinte një gllënjë të vogël dhe e vendoste ngadalë mbi tavolinë.

«Ndonjëherë më del gjumi natën dhe ndiej një si... boshllëk. Brenda vetes. Ndonjëherë më ndodh që boshllëkun ta ndiej përpara se të fle gjumë, kjo ndodh atëherë kur unë jam shtrirë, por gjumi është ende duke kërkuar rrugën për te unë. Kurse në mëngjes», Sotiri kthente kokën dhe më shikonte si për herë të parë dhe hapte krahët. «Në mëngjes, nuk e ndiej aspak. Dhe e di?... ndonjëherë më ndodh sërish të nevríkosem me të, arrin ta besosh?»

Patjetër që unë arrija ta besoja dhe pohoja duke lëvizur kokën lehtë.

«Sepse ajo kishte atë – ti e di – atë maninë e të lënurit mënjanë të gjërave të vogla.»

Herën e parë që i tregova Natashës sime Historinë Sipas Sotirit, ajo, mbaj mend të mos ketë folur për një kohë të gjatë. Ishim në dhomën e gjumit, shtrirë në krevat dhe ajo duhej të ishte një lloj ninulle. Natasha ime u ngrit prej krevatit dhe doli në kuzhinë. E ndjeva të merrej me kanatat e bufesë për një farë kohe dhe pastaj u kthye. Kishte bërë analizën e vet sipas mënyrës së saj dhe tani ishte gati.

«Do të dëgjosh se ç'mendoj?» tha, ndërsa futej poshtë mbulesave. Unë heshta dhe ajo e përktheu si një po. «Do të ta them», vazhdoi ajo. «Por më parë më thuaj, *ti* nga cila anë je?»

«Çfarë do të thuash?»

«Hajde tani, mos më thuaj se nuk e ke menduar.»

Ja çfarë do të thotë tridhjetë e tre vjet martesë, kam menduar atëherë. Gruaja të lexon mendjen si të jetë një libër i hapur. Ishte e kotë të kundërshtoja, e dija, por vendosa të mos dorëzohesha menjëherë.

I thashë: «Sigurisht që e kam mendar, por s'më ka shkuar në mendje se duhet të mbaj anën e ndonjërit. Për mua s'ka anë për të mbajtur.»

«Posi, ore posi. E di se ç'do bëja unë po të kishte edhe ti *fiksime* të atij lloji?» Unë hapa gojën të kundërshtoja, por ajo s'më la. «Sepse për fiksime bëhet fjalë dhe as mos u mundo të më kundërshtosh.»

«Çdo njeri ka të gjërat e veta.»

«Jam dakord.» Natasha tërhoqi batanijen deri në mjekër. «Por ne të njëjtin moment që këto gjëra dalin jashtë, ato bëhen edhe gjërat e tjetrit. Në çast.»

«Varet.»

Natasha u ngrit në bërryla. «Nuk ka varet, Dalip. Për sa kohë jeton nën të njëjtën strehë me dikë, nuk ka *varet*.»

«Sikur do thoshe se çfarë mendoje», ndërrova bisedë.

Natasha më vështroi me ngulm për një çast, e kuptoi që në një farë mënyrë unë u dorëzova dhe rihodhi kokën mbi jastëk. «Mirë», tha. «Por do të të bëj një pyetje ama, edhe pse e di se s'do të të pëlqejë.»

Dhe, në të vërtetë, nuk më pëlqeu aspak.

Që nga ajo natë, Natasha ime, çdo herë që Sotiri vinte e më tregonte historinë sipas tij, më pyeste, më mbrapa, nëse ia kisha bërë atij pyetjen e saj. Sigurisht unë nuk mund t'i bëja Sotirit një pyetje të atillë, por e pyesja për gjërat e vogla, ama. Po, për ato e pyesja.

Sotiri merrte kohën e vet. Pavarësisht nga pyetja ime, ishte sikur në mendjen e tij të qe krijuar një itinerar, i pamundur për tu ndryshuar.

«Ishte një grua e mirë», thoshte. «Shumë e mirë. Apo s'dinte të gatuate! E ke dëgjuar kur thonë që kuzhina e mirë e gruas, i zgjat jetën burrit? E pra, unë, nga kjo anë, e kisha të

sigurt jetën e gjatë. Në të gatuar, Sa-e-mira nuk kishte as rivale e as rivalë, tamam si Natasha jote për turshitë.»

Sigurisht, Natasha ime është se di të bëjë vetëm turshitë, por nuk kishte vend për të bërë komente.

«As Miço Djali nuk ia merrte dot», vazhdonte Sotiri. Miço Djali ishte djali i madh i Miço Zelos, Ylli. E thërrisnin Miço Djali, sipas një emri të shpikur nga ai vetë. Thoshte se në Amerikë, kështu i thërrisnin fëmijët: duke i futur emrit të babait një ‘xhunior’ nga mbrapa dhe hajt natën e mirë. Gjynah, në fakt, gjithë ajo Amerikë të vuajë për emra, por nejse. Miço Djali për sa kohë qëndroi në Drelan kishte një restorant në të hyrë të qytetit dhe ai ishte krenaria jo vetëm e atij, por edhe nga Tirana kanë ardhur e kanë ngrënë mishin në prush të tij, apo tavat e salcat... e të tjera e të tjera.

E megjithatë, as ai nuk ia merrte dot gruas së fotografit: fjalë burri e vetë fotografit.

«Çdo të martë shkoja në Tiranë, ti e di, çoja filmat. Kur kthehesha, në darkë, e gjeja tavolinën shtruar. Nuk ka gjë më të kënaqshme, Dalip, sesa të kthehesh nga një punë e lodhshme dhe ta gjesh shtruar.»

«E kur kësaj i shton edhe cilësinë e ushqimit...»

«Mmmm», ia bënte Sotiri. Pastaj, të dy, zgjasnim trupin përpara dhe merrnim nga një copë turshi dhe e futnim në gojë. Mbasi e kalonim poshtë, kthenim edhe nga një gllënjë ‘ujë të bekuar’. Aty pastaj, Sotiri, bëhej serioz. «Vetëm, më thuaj, çfarë do bëje ti më parë? Më parë do haje, apo do laheshe?»

Natyrisht që unë, më parë, do lahesha.

«Është normale, dreqi e hëngrët. Vjen tjetri nga një rrugë e gjatë, me një autobus që qelb erë, ngaqë në të hipin me qen e me mace dhe e gjithë kjo, mbasi ka kaluar një ditë të tërë mes pluhurit të Tiranës – sepse Tirana, pluhur ka sinonimin Dalip, edhe pse është kryeqyteti dhe kush e di se ç’mund të mendojnë njerëzit. Është pluhur i gjallë, vetëm ta shohësh. Gjithsesi, mbas një rruge, mbas *çdo* lloj rruge, njeriu, në fillim, ka nevojë të lahet. Të heqë nga vetja erën e autobusit, erën e cigares, erën e pocaqisë.

«Sa-e-mira ime, natyrisht, e dinte këtë gjë. Ia kisha thënë me dhjetëra herë. Unë mendoj se arrin një pikë e martesës që s’ke më nevojë t’i thuash gjërat, mjafton t’i mendosh.»

Unë kujtoja gjithmonë Natashën time dhe konfirmoja me kokë.

«Sa-e-mira e përgatiste edhe ujin: kjo ishte e bukura. Ujin e përgatiste, domethënë, në kohën e kanoçes, e vinte ujin në zjarr që më përpara dhe mua më duhej vetëm ta ftohja, kur erdhi koha e dushit, thjesht vinte bulierin në prizë një orë – një orë e gjysmë para se të vija unë dhe ai ishte gati kur unë hyja në shtëpi. Por, në të njëjtën kohë, nga ana tjetër, shtronte edhe tavolinën. Tani, unë do lahesha, kjo ishte e sigurtë, dua të them, nuk e luante as topi, e nga ana tjetër, darka do të ftohej në pjatë dhe, kur unë të dilja nga dushi, asaj do i duhej ta ngrohte sërish.»

Sotiri hapte krahët në një gjest të tipit “ja, kjo është, s’ke ç’t’i bësh: kur u ndanë, këto na ranë.”

«Ç’i thua ti kësaj?»

Unë, personalisht, s’i thosha gjë kësaj. Natasha ime po. «E çfarë problemi kishte ai xhanëm», mendonte ajo. «Sikur do e ngrohte vetë ai.»

«Vërtet unë nuk do e ngrohja vetë gjellën», shpjegonte Sotiri. «Por përse duhet ngrohur gjella *dy* herë. Këtu qëndron i gjithë problemi: jo tek fakti që do haja gjellë të ftohtë, sepse nuk do ndodhte, kjo dihej; puna ishte se gjella ngrohej për herë të dytë.

«Për herë të dytë, sepse herën e parë është ngrohur kur është vënë në tryezë, pak para se të kthehesha unë – ta them që të mos kujtosh që ajo e gatuante pikërisht atë moment. Hera e dytë që do ngrohej gjella ishte kur të dilja nga dushi. Pse?

«E para kjo.

«E dyta: po të llogarisësh korrentin, do zbulosh që po e harxhon dyfish *për të njëjtën gjë*. Ngroh – ftoh – ngroh prapë. Le pastaj po të shtosh edhe *kohën* dhe *energjinë* që, gjithashtu, ia kushton dyfish. S’e di, një gjë kaq elementare...»

Sotiri zgjatej përpara dhe merrte gotën e rakisë dhe kthente gllënjikën e fundit. Unë i zgjasja shishen sërish.

«Ja», ia bënte ai ndërsa i hiqte tapën. «Është njëlloj sikur unë tani të hedh vetëm një gllënjikë raki në gotë, ta pi dhe pastaj ta mbush sërish po aq. Ndërkohë që mund ta mbush gjer në buzë, të pi gllënjikën time të radhës e të mbetet sërish. Pse duhet ta mbush gotën shtatëqind here, xhanëm?»

Sotiri i vinte sërish tapën shishes dhe e linte mbi tavolinë. Pastaj vendoste edhe gotën e vet pranë saj, natyrisht, mbasi pinte gllënjikën e radhës.

E kalonte tek kafeja.

«Sa herë jemi ulur bashkë në një lokal, Dalip?»

«Ah, e kush i numëron.»

«Bukur shumë, se edhe mua nuk është numri i herëve që më intereson. Tani, të pyes: e di ti si e pi unë kafënë?»

E mbaja mend, sepse ai e pinte identik si unë. Kam përshtypjen se po ta pinte *ai* me sheqer, mund edhe të mos e dija se sa qese i hidhte, por, në qoftë se *unë* do e pija me sheqer, do e mbaja mend... besoj.

«Të hidhur e pi, të uruarën. Të hidhur, pa sheqer. Ti e di... e ke vënë re dhe *e mban mend...*»

«Sepse edhe unë e pi kështu, prandaj», mundohesha ta provokoja pakëz, duke e ditur që i pëlqente.

«Edhe po ta pije me sheqer, do e mbaje mend, të jesh i sigurt», ia priste ai atëherë dhe unë dorëzohesha. «Kamerieri e mban mend, Dalip. Dhe nuk e kam fjalën vetëm për Bledin e Vasit, jo. *Çdo* kamerier e mban mend. Vetëm kur vete për herë të parë në një lokal të ri, ndodh që kamerieri të mos dijë se si e pi kafënë dhe është normale: është hera e parë që të shikon. Por herën e dytë apo të tretë, mik i dashur... ta sjell ashtu siç duhet: pa qese sheqeri në pjatë. Lugën ta sjell, sepse ka nga ata që e përziejnë kafënë edhe pse e pinë pa sheqer. Unë jam një nga ata, ashtu si edhe ti.»

Pa sheqer po, por ajka e kafesë do përzier me pjesën tjetër, ndryshe pi kafe lart dhe lëng gështenje poshtë.

Sotiri njomte fytin me 'ujë të bekuar'. «Tani, unë jo gjithmonë e pi kafënë në lokal. Përkundrazi, kafënë e mëngjesit e pi në shtëpi. Ç'ndodh? mendon ti.» E, natyrisht, pa prituri përgjigje: «Ndodh që gruaja jote të bën kafënë – dhe oh, për atë zot, si e bën ajo kafënë, s'ka kamerier a barist a ç'të të them unë që ta bëjë – por karshi saj të ve edhe vazon me sheqer. Të hap edhe kapakun – sepse është duke të të bërë sa më shumë shërbim, kupton? – dhe të lë edhe lugën ngulur në masën e bardhë si të ishte ajo shpata e mbretit Artu'. Dhe ti, para se të ulesh në tavolinë, pyet veten: 'Ore, po sa vite kam që jam martuar me këtë grua, ëh?' Vetëm se përgjigjen e pyetjes e vret përpara se të dalë nga mendja, sepse është një përgjigje që të shkakton dhimbje. Gruaja jote nuk e di se si e pi ti kafënë. 'Po mirë', do thuash ti, 'pse duhet ta dijë? Tek e fundit gruaja jote është, nuk është gruaja e komshiut.'»

Në këtë pikë, Sotiri bënte një tentativë të keqe për të qeshur.

E unë e dija përse.

«Ta kisha ditur», më tha Natasha ime, kur ia tregova atë natë, «do ia kisha sjellë gjithmonë me sheqer. E pa lugë madje, me pretendimin se kujtoja se i hidhte sheqer, por nuk e trazonte.» E mbasi unë vura buzën në gaz, shtoi: «Hej, është Malda, gruaja e Vllasit që e pi kështu, sinqerisht.»

Unë e besoja që gruaja e karrocierit i hidhte sheqer kafesë dhe nuk e trazonte, por nuk besoja se nëse Natasha ime do shtirej sikur nuk e mbante mend se si e pinte kafenë Sotiri, ky nuk do ia vinte gruas së vet në llogari.

«E di ç’do të thuash: këto janë vetëm vogëlsira, do të thuash. Por pikërisht këtu qëndron puna, Dalip. Këto nuk janë thjesht vogëlsira, ose për të qenë më i saktë, nuk janë vogëlsira të pavlera. Jo, janë me vlerë. Sepse çdo gjë, Dalip, çdo gjë, ka rëndësinë e saj. E di, kam lexuar në një poezi diçka të ngjashme, por që nuk e gjej që nuk e gjej dot se ku, por mbaj mend që seç kishte diçka që fliste për fijen e barit dhe rëndësinë që ajo kishte për një milingonë. Fija e barit, për ty e mua, nuk ka aspak rëndësi, kur është një e vetme. Një tufë e tërë po. Edhe lopa me tufa e do; një fije bari të veçuar mbas një guri as që e shikon. Por ajo fije bari, që thua ti, bën një hije të vockël, shumë të vockël vërtet, ku poshtë saj të mund të pushojë për disa çaste një milingonë punëtore. Më vjen keq që s’më kujtohet autori, por kjo më ka mbetur në mendje. Dhe jam shumë dakord me atë që e ka shkruar. Shumë dakord. Çdo gjë ka rëndësinë e vet. Edhe këto që po të tregoj tani, Dalip. Një tullë e vetme është vetëm një tullë, por shumë tulla njëra mbi tjetrën bëjnë këtë verandën ku jemi ulur tani unë e ti.»

*Si bëhet kalaja?* Pyesja veten në heshtje.

Sotiri pushonte për disa çaste, tamam si ata oratorët e mirë me njohuri psikologjike që mbasi thonë pjesën më të rëndësishme të fjalimit të tyre, heshtin, me qëllim që dëgjuesit e tyre të asimilojnë sa më mirë konceptin. Pastaj vazhdonte.

«E di ç’të bënte në mëngjes? Ngriheshim. Gjëja e parë që bëhej ishte larja e dhëmbëve... tashmë ka kohë që ‘larja e dhëmbëve’ ka parakaluar në renditje atë gjënë tjetër që bëhej ende pa u ngritur prej krevatit, besoj se më kupton përse e kam fjalën, apo jo?»

«Sigurisht, Sote, edhe unë e kam përjetuar atë kohën kur ndonjë pjesë e trupit tim ngrihej përpara meje. Vetëm se, tani, ti ngrihesh e jo vetëm që s’është ngritur gjë para teje, por, po të ndodhi andej nga dreka, eh, je me fat.»

«Pikërisht. E pra, laheshin dhëmbët, në fillim. Sa-e-mira ngrihej gjithmonë para meje, natyrisht, kurse unë rrija e rrotullohesha edhe ca në krevat. Por e dëgjoja. Që nga krevati im e dëgjoja. Kur ajo lante dhëmbët, e kam fjalën. Sepse ajo e kishte zakon që të linte ujin e çezmës të rridhte *ndërsa* ishte duke larë dhëmbët. Dua të them edhe atëherë kur ajo ishte *duke fërkuar* dhëmbët me furçë.

«Unë e mbyll çezmën, kur i laj. Kur fërkon dhëmbët me furçë, uji s'ka përse të rrjedhë kot, apo e kam gabim? Përse duhet të rrjedhë kot? Përse duhet harxhuar? Mbaron së fërkuari dhëmbët, të duhet të shpëlash furçën. Atëherë hap çezmën dhe e bën. Pikë. Më thjeshtë se kaq, s'ka ku të vejë.

«Dhe kjo tregon pakujdesi, Dalip. Indiferentizëm. Dhe me këtë punën e ujit, e kishte gjithmonë kështu, jo vetëm kur lante dhëmbët. Kush e di sesa herë kam pyetur veten se çdo të ndodhte sikur ajo të kishte qenë në gjendje të bënte fëmijë.»

Këtu ndieja me të vërtetë se duhej ta kundërshtoja dhe jo thjesht për faktin që atij mund t'i pëlqente. «Tani po e ekzagjeron», i thosha. «Nuk mund të krahasosh një rubinet çezme me një fëmijë.»

«*Sikur* të bëhej fjalë vetëm për rubinetin! Deri tani të kam vënë përpara vetëm tre tulla, por prit edhe ca e do shohësh që do bëjmë një verandë më të madhe se kjo ku jemi ulur.»

«Po përsëri nuk mendoj se është e drejtë të bësh një supozim të tillë.»

«Në '92-shin bleva makinën. Ti e di, unë isha ndër të parët që bleva një makinë në Drelan.»

Më kujtohet hera e parë që Sotiri erdhi me makinën e tij nga Tirana. Ishte sikur ai të kishte ardhur me ndonjë avion. Pothuaj i gjithë qyteti u mblodh në lagjen tonë për të parë Mercedesin 200 të fotografit. Mbjaj mend që bashkë me makinën, Sotiri solli edhe një qen të zi me kokë të madhe, të cilin e lidhi mbas derës së shoferit, me qëllim që t'i ruante makinën. Në mëngjes kur u zgjua, gjeti dorezën e makinës të thyer. Qeni ia kishte mbathur. Për fatin e tij të mirë, makina ishte ende aty e aty do të qëndronte për gati një vit. Gjersa Sotiri vendosi ta shiste e të blinte një tjetër, përsëri një Mercedes, por kësaj radhe, një 190.

«Dy vjet më vonë, gruaja ime mësoi të ngiste.»

Një vit më vonë, në 1995, Sajmira u bë e para femër e Drelanit me makinën *e saj*. Ishte shkurt, kur ndodhi. Në qershor të po atij viti, ajo u zhduk.

«E di se ç'bënte me makinën? E linte gjithmonë hapur. Madje kishte raste që e linte edhe *ndezur*. Unë për vete, ti e di, mundohesha ta përdorja sa më pak të ishte e mundur, makinën. E ç'ta përdorësh këtu në këtë qytezë, që të gjithën ta bredhësh në këmbë, të duhet jo më shumë se çerek ore? 'Jo', thoshte ajo. 'Makina duhet përdorur, ndryshe kot sa e blen.' 'Mirë', ia ktheja unë, 'por makina edhe *mësohet* se si të përdoret ama.'

«Dhe nuk e kisha fjalën vetëm për ta ngarë. Dalip, kur them se çfarë do ndodhte sikur zoti të na kishte falur mundësinë e të pasurit të një fëmije, kam parasysht gjithnjë *pakujdesitë* e saja. Gjërat shikohen nga larg. Ja, të jap një shembull.» Sotiri merrte gotën e rakisë, pinte gllënjken e fundit që kishte mbetur në të, pastaj e afronte përpara syrit të majtë, që përmes qelqit ngjante me syrin e një ciklopi. «Ti shikon këtë gjë nga kaq afër dhe pyet çfarë është. 'Qelq', thua dhe është më se e saktë, si përgjigje. Por...» Sotiri shtrinte krahun në ekstremin e të cilit gishtat shtrëngonin gotën. «Por, në qoftë e shikon kështu, zbulon se, në realitet, është një *gotë* qelqi. E, nëse edhe e rrotullon, apo e anon pak kështu, shikon se është një gotë qelqi me diçka të lëngët brenda... beh, tani i ka ngelur vetëm një pikë nga ajo gjëja e lëngët, por arrin të kuptosh që dikur e ka pasur brenda. E, nëse e afron sërish e i merr *edhe* erë, arrin në përfundimin që bëhet fjalë për një gotë qelqi që ka pasur brenda *raki*, prej së cilës, tani, ka mbetur vetëm një pikë.»

«Ajo që dua të them, Dalip, është se gjërat duhen parë nga një këndvështrim *i gjerë*, për të arritur në një konkluzion të saktë. Prandaj them», vazhdonte pastaj, ndërkohë që mbushte me raki gotën e tij prej qelqi për të fundit herë. «Në qoftë se një njeri është i pakujdesshëm për një gjë, kjo nuk do të thotë se është i pakujdesshëm në gjithçka. Por, në qoftë se ky njeri tregohet i pakujdesshëm në *shumë* gjëra, atëherë ai është i pakujdesshëm *në të gjitha* gjërat. Sigurisht, duhet të kuptosh që pakujdesshmëria e tij ndryshon nga njëra gjë në tjetrën. Sa-e-mira thoshte se gjërave të vogla s'ke pse u kushton më shumë rëndësi nga ç'duhet, por unë them: 'kush është që e përcakton masën e rëndësisë së një gjëje?'. Largoje gjënë nga vetja dhe shikoje mirë, nga të gjithë këndvështrimet.

«Një gjë është e vogël, jo sepse ka rëndësi të vogël, por sepse aq është vendi që ka zënë në jetë. Një njeri mund të mos i kushtojë shumë rëndësi *orës* se kur duhet të lajë pjatat dhe *kohës* që duhet të harxhojë për atë veprim, por shko në një restorant, pyet pjatarësen dhe shiko se ç'do të thotë. Do të thotë që ajo që ti, në shtëpinë tënde, e quan një gjë të vogël me

rëndësi të vogël, për atë do të thotë të mbajë fëmijët me bukë. E kjo s’do të thotë që pjatatarësja të shkojë në shtëpi dhe t’i lërë pjatat pa larë. Më kupton?»

Beh, të them të drejtën e kuptoja, por deri në një fare pike ama.

«Sa-e-mira kishte zakon të thoshte se, atëherë kur duhej, ajo ishte në gjendje të ndërronte masën e përkujdesjes. E përkthyer, kjo do të thotë se “e kuptonte se kur duhej të ishte e pakujdesshme dhe kur jo”. Për të njëjtën gjë të vogël. Gjepura. Një herë të ngulitur në mendje që diçka është e parëndësishme, s’ke për ta kthyer kurrë në diçka të rëndësishme, madje edhe gjërat e rëndësishme do të duken më pak të rëndësishme.

«Prandaj edhe unë bëj krahasimin me fëmijën, Dalip. Sepse nuk mendoj se po të kishim fëmijë të vogël në shtëpi, ajo do t’u kushtonte... nuk po them më shumë rëndësi, por rëndësinë e duhur, këtyre gjërave të vogla. Jo, përkundrazi: thjesht do kishte më shumë gjëra të vogla, të cilave do u mohonte rëndësinë.

«Vetëm duke i mbledhur të gjitha, vetëm duke jetuar çdo ditë me një njeri, mund të arrish në konkluzione të tilla. Mos vallë kujton që unë nuk jam munduar ta kuptoj? Sigurisht që jam munduar. Edhe unë në fillim, kështu si ty mendoja. ‘Nuk ka mundësi’, i thosha vetes. ‘Nuk mund të bëhet një krahasim të tillë. Po të kishim fëmijë, *patjetër* që ajo do sillej ndryshe.’

«Po si ndryshe? Çfarë ndryshe? ‘Njerëzit janë ajo që hanë’ është një shprehje – më duket se italiane, nuk e di – por unë mendoj se njerëzit janë edhe *ato që bëjnë*. Në fund të fundit, gjithçka që ne bëjmë është thjesht pasqyra e asaj që kemi përbrenda. Nuk po flas tani për konceptin ‘e mirë’ – ‘e keqe’: kur them ‘*përbrenda*’ i jap më shumë rëndësi kësaj...» Dhe Sotiri prekte tëmthin e majtë me gishtin tregues. «...se sa kësaj». Sotiri vendoste pëllëmbën mbi kraharor.

«Kjo është më e rëndësishmja. Koka. Po qe se ato gjërat brenda saj nuk punojnë ashtu si duhet...»

Sotiri e linte frazën përgjysmë dhe kthente një gllënjë raki. Qëndronte edhe për një çast tjetër pa folur, duke i zgjatur faqet freskisë së erës që kalonte në verandë. Pastaj, mbasi ajo t’i kishte freskuar idetë, riniste tregimin.

«Sa-e-mira nuk ishte debile, nuk jam duke thënë këtë. I vetmi problem i saj, ishte mosdhënia rëndësi, *ashtu siç duhet*, gjërave të vogla. ‘Ehu, edhe ti’, thoshte gjithmonë, ose

‘Hë mo, se një gjë e vogël është’, ose ‘Gjë që rregullohet’: gjëra të kësaj familjeje, domethënë.»

Sotiri tundte kokën ashtu siç mund ta tundë dikush i cili ka dyshimet e veta në lidhje me atë që është duke dëgjuar. Natyrisht, Sotiri nuk kishte dyshime me ato që ishte duke thënë. Dyshimet e tij lidheshin me atë që ishte duke *menduar* ato momente.

Nuk e di nëse fjalët e tij shprehin atë që mendonte, por thoshte: «Sinqerisht, Dalip, ndonjëherë, më hipte dëshira t’i vija duart në fyt. Po, po, e pranoj. Nuk është diçka e mirë, por e pranoj që disa herë, me të vërtetë e kam marr në konsideratë këtë gjë.» Pastaj kthente rrëmbimthi kokën nga unë. «Hej, vetëm për një leksion të vogël, dua të them, ëh? Se mos më keqkuptosh.»

Por, unë, vetëm herën e parë, mbaj mend ta kem keqkuptuar. Herët e tjera më vinte ndër mend

*(Mirë, por do të të bëj një pyetje ama, edhe pse e di se s’do të të pëlqejë.)*

pyetja që më kishte bërë Natasha ime natën që i tregova rrëfimin e tij.

«Unë kam përshtypjen se ai ka shkuar më tej sesa thjesht ‘marrja në konsideratë’», më bëri të ditur Natasha ime. «Një herë i kam dëgjuar të zihen keq dhe kam parë Sajmirën të largohej me makinë. Dukej e xhindosur. Dhe kishte një diçka të zezë poshtë syrit të majtë. Një njollë. Tani që po më thua këtë gjë, arrij të bëj lidhjen e duhur.»

Edhe atë ditë, Natasha ime kishte menduar se mos Sotiri kishte vënë dorë, por disa ditë më vonë, Sajmira iu rrëfye *vetë* Natashës sime, duke i thënë se, në realitet, ajo kishte qarë dhe njolla kishte qenë thjesht lapsi i syve. Arsyen pse ishin zënë, ama, nuk ia kishte treguar. Pyetjes së Natashës sime, Sajmira, i ishte përgjigjur thjesht me një ngritje supi.

«Nuk jam aq budallaqe sa ta ha dhjamin për djathë», m’u shfajësua Natasha ime. «Po të qe se poshtë syrit do i kisha parë ende shenjën e zezë, sigurisht që s’do e besoja historinë e lapsit. Por s’kishte.»

«Kjo nuk është e mjaftueshme për ta etiketuar Sotirin si rrahës së gruas», kundërshtova.

«Besoje instinktin e një gruaje, Dalip: kur një burrë thotë se, *ndonjëherë*, i vjen në mendje të vërë dorë mbi gruan e vet, ka vënë, e nëse akoma jo, herët a vonë do e bëjë. Në rastin e Sotirit, gruan nuk e ka më... *afër*. Konkluzioni: *ka vënë*. Po ty, burro, të ka shkuar ndonjëherë mendja?»

«Ndonjëherë.»

«Atëherë qënkiem njëlloj, thashë mos isha vetëm unë.»

Pavarësisht batutave, unë nuk e besoja instinktin e gruas sime... për rastin në fjalë. Sepse të besoja, do të thoshte se duhej të bëja pyetje të tjera të papëlqyeshme.

Ditën që Sajmira Muzaka i hipi Mercedesit dhe la kopshtin e shtëpisë së saj për të mos u kthyer më, unë isha në shtëpi, por nuk e pashë. Zhurmën e motorit po, e dëgjova. Natasha ime e pa. Ajo ishte në verandë duke mbledhur rrobat e bardha që kishte nderur një natë më parë. Ishte diçka midis orës 11.30-12.00 kur ndodhi. Edhe Natasha ime, në fakt, arriti të shikonte vetëm makinën dhe siluetën e Sajmirës brenda saj. Ishte normale, nuk kishte pse t'i kushtonte shumë rëndësi. Asnjëherë nuk e kishte bërë... me përjashtim të rasteve kur dëgjonte *fjalë*. Atë ditë nuk kishte dëgjuar *fjalë* dhe ishte normale, sepse ishte e martë. Sotiri ishte në Tiranë. Kur u kthye, andej nga ora shtatë e mbrëmjes... eh besoj se është e lehtë të imagjinohet që nuk gjeti të përgatitur as darkën e as dushin. Se çfarë bëri ato orë, Sotiri ka preferuar t'i mbajë për vete, por andej nga ora dhjetë e gjysmë, trokiti në derën e shtëpisë sime.

Natasha ime i tha atë që kishte mundur të shikonte, si dhe orën se kur e kishte parë. Të njëjtën gjë, Natasha ime i përsëriti edhe policisë që erdhi një orë më vonë. Vetë gruaja ime arriti ta bindte Sotirin – por edhe mua – ta lajmëronte.

«Nuk ka mundësi. Me siguri që ka shkuar tek ndonjë shoqe dhe do kthehet nga momenti në moment.»

Edhe unë kisha të njëjtin mendim me Sotirin. Por Natasha ime jo.

«Sa herë ka ndodhur që të mos jetë në shtëpi duke të të pritur, kur ti vjen nga Tirana?»

«Me siguri i ka ndodhur ndonjë gjë makinës dhe ka ndaluar ta rregullojë. Ose ia kanë vjedhur dhe është duke u kthyer në këmbë.» Të dyja mundësitë, Sotri i shprehu me tonin e dikujt që është lodhur që thëni ato gjëra, por aso kohe, as unë e as Natasha ime nuk qemë në gjendje të kuptonim përse. Atë ditë nuk dinim ende gjë në lidhje me gjërat e vogla.

«Pikërisht, prandaj dhe duhet lajmëruar policia.»

Dhe u lajmërua.

Policia mori dëshmitë që kishte për të marrë, mblodhi faktet që ishin për tu mbledhur dhe iku, duke lënë aty një burrë 'që e kishte humbur' dhe gjithë lagjen në të cilën ai banonte.

Policia u shfaq sërish në oborrin e shtëpisë së fotografit vetëm dy ditë më vonë. Atë që fotografi ishte mësuar të bënte gjatë gjithë jetës së tij, tani e bënte një prej dy policëve me uniformë bojëqielli.

«Kur pashë fotografinë e parë, gati sa s'më ra të fikët në mes të oborrit. Kisha dy ditë që mendoja se ajo kishte ikur te... te dashnori i saj dhe... . Po, Dalip, po. Edhe unë e dija.»

*Edhe unë e dija.* E thoshte, sikur unë ta kisha të skalitur në ballë që isha në dijeni për adulteret e saj, ndërkohë që, unë, nga ai po e mësoja për herë të parë. Asnjëherë nuk ia tregova këtë gjë Sotirit. Nuk do kishte shërbyer për gjë tjetër veçse për të humbur pikë në miqësinë me të. Sepse, natyrisht, ai nuk do të më kishte besuar... të paktën jo plotësisht. Mund ta kishte interpretuar si një mënyrë timen për të shprehur keqardhjen ndaj tij dhe ai, keqardhje nuk donte. Ma kishte thënë vetëm një herë: herën e parë dhe, pavarësisht se nuk e përmendi më, unë e mbajta vëth në vesh.

«E dija. Një burrë e kupton... kam përshtypjen ashtu si edhe një grua *mund* ta kuptojë. Kisha disa javë që e kisha mësuar. E kisha parë tek *mënyrat* e saj. Jo më kot të thashë më lart, Dalip, që njerëzit janë ato që bëjnë. Sa-e-mira ime filloi të bënte gjëra që ajo *nuk* ishte. Një ditë e gjeta tek lante dhëmbët dhe... e di më e bukura? kishte mbyllur çezmën. Por më e bukura fare qëndron gjatë: nuk i kishte larë kurrë dhëmbët *në drekë*. Kurrë, Dalip. Këtë gjë ma ka thënë qysh kur kemi qenë student dhe unë nuk e harrova kurë. Sepse unë, dikur, i laja dhëmbët në drekë, por kur fillova të jetoj me Sa-e-mirën, e ndryshova atë zakon. E ndryshova për hir të saj.

«Ajo nuk i kishte larë kurrë, në drekë. Rifilloi një ditë të bukur dhe e di si më tha? 'Njeriu edhe ndryshon *habitat* ndonjëherë.' Ja kështu më tha. *Habitat*.» Sotiri e thoshte '*habitat*' me një dozë shumë të madhe përçmimi. Pastaj kthente kokën nga unë. «Puna qëndron, Dalip, se po, jam dakord që njeriu ndryshon *habitat*, por pse? 'Pse?' është pyetja kyçe. Sterjo Spasse ka bërë një roman të tërë 'Pse?'. Edhe unë ndryshova *habitat*, dikur, kur isha student, por, *sepse* dashuroja një vajzë e cila nuk e kishte atë lloj *habitati*, sepse unë do jetoja me të dhe atë kohë, mu duk e arsyeshme që të ndërroja *habitat* tim, aq më tepër që përpara meje po vinte një kohë – unë e dija – ku nuk do kisha shumë kohë për atë lloj *habitati*.»

Sotiri ndalonte dhe mbushej me frymë. Pastaj, rifillonte sërish, kësaj here me një ritëm normal.

«Sa-e-mira ka pasur, gjithmonë, gjithë kohën e drekës në dispozicion. Mbas buke, mund të lante dhëmbët, jo një herë, por dhjetë herë dhe asnjëherë nuk e kishte bërë. Sepse, mbas dreke, e kishte zakon t'i linte pjatat në lavaman që t'i lante në darkë dhe... çfarë, s'e pata thënë këtë?»

Diçka me pjata kishte thënë, por jo atë të gruas së tij.

Mohoja me kokë.

«Oh, natyrisht. 'Gjë e vogël', më thoshte. 'Ç'bën në drekë e ç'bën në darkë.' Po se gjithë kuzhina mbushej me erën e tyre dhe me miza, punë e madhe! Ç'bënte në drekë e ç'bënte në darkë! Që t'ia merrje pjatat e t'ia thyje të gjitha në kokë! Kështu e donte, sinqerisht. Por unë nuk e bëra asnjëherë. Tjetrin duhet ta duash me gjithë të mirat dhe të metat që ka... e për fat të keq, edhe atëherë kur të metat janë më shumë.

«Gjithsesi, siç po të thosha, tani, pa pritur e pa kujtuar na ndërronte *habitat*. Bashkë me larjen e dhëmbëve në drekë, ndryshoi edhe habitatin e enëve. Në një farë mënyre, Dalip, ndryshoi pak nga gjithçka.»

Sotiri i hidhte një sy të shpejtë orës. Mesnata ishte pranë. Tashmë pjata me meze mbi tavolinë ishte zbrazur me kohë dhe të njëjtin fund kishte pësuar edhe shishja me 'ujë të bekuar'. Por Sotiri kishte edhe pak histori që duhej çuar në fund.

«Një ditë vendosa të përballesha me të. Isha i sigurtë që herët a vonë, dikush do të ma thoshte. Sigurisht, nuk besoja se ai *dikushi* do të trokiste në derën time e as do gjeja letrën e një miku që më donte të mirën poshtë dere, por e dija se herët a vonë do e dëgjoja nga dikush. E ndieja. Kështu që mendova të përballesha me të njëherë e mirë.»

Sotiri merrte një pushim të vogël për disa sekonda, gjatë të cilave fërkonte qimet e mjekrës e unë mendoja: *kjo është ajo që ai i thoshte vetes, por e vërteta është se thellë – thellë ai ende shpresonte që të kishte gabuar në nxjerrjen e konkluzioneve të veta.*

«Përveç se të përballesha me të, kisha marrë në konsideratë edhe ndjekjen», vazhdonte Sotiri. «Por kam pasur frikë. Çfarë mund të bëjë një njeri që zbulon gruan e vet me një tjetër? E kam fjalën, çfarë do të bëjë në qoftë se edhe e *gjen* bashkë me një tjetër?

«Nuk arrita të bëja as njëherë e as tjetrën. As e ndoqa e as arrita të përballesha me të. Ndoshta sepse frika ime ishte më e madhe sesa impulsi për të mësuar. Diku kisha lexuar se një injorant është më i lumtur sesa një i ditur, por vetëm ato ditë të dilemës sime fillova të besoja në vërtetësinë e atyre fjalëve. Ndoshta, po të mos e vërtetoja do të ishte më mirë. Për

sa kohë nuk e vërtetoja, krimbi i dyshimit nuk do kishte kurrë mundësinë të hante gjithë frytin. Nga ana tjetër, *pritja* në të cilën jetoja çdo ditë, nuk më linte të qetë. Më dukej sikur isha duke ecur mbi një urë me dërrasa të kalbura, me ankthin se nga çasti në çast ndonjëra prej tyre do t'i dorëzohej peshës sime dhe do bija për poshtë. Vetëm se nuk e kisha idenë se *ku* do të bija: poshtë urës do kishte ujë, apo thjesht një humnerë pa fund?»

Sotiri mbyllte sytë dhe psherëtinte thellë.

«Pastaj», vazhdonte duke i rihapur. «Ajo vendos të largohet vetë dhe më çliron nga dilema që më kishte mbirë në kokë. Kështu ndodhi: mori me veta gjithë të mirat dhe të metat dhe iku. E, papritur, unë s'kisha më arsye pse të vrisja mendjen se çfarë të bëja: të përballësh me të drejtpërsëdrejti, apo ta ndiqja nga mbrapa si një spiun? Shpëtova.

«Nga kjo anë.

«E hëngra nga ana tjetër.

«Sa-e-mira më hoqi qafe barin e keq dhe unë arrita të shikoja tufën e shkurre me gjemba. Vërtet të kishte qenë duke ikur tek dashnori i saj atë ditë? Kjo është, Dalip Kliandi, pyetja që më torturon çdo natë të vetme. Dhe, tani që Sa-e-mira e mori përgjigjen me vete atje ku shkoi, vetëm zoti mbetet që ta dijë. Ti mendon se do të ma thotë ndonjëherë, zoti? Jo, s'besoj.»

E, thënë këtë, Sotiri ngrihej më në fund prej karriges.

Varrimi i gruas së fotografit u bë dy ditë mbas gjetjes. Nuk pati asnjë lloj ekzaminimi, asnjë lloj autopsie domethënë, pavarësisht nga ato që mund të dëgjojë ndonjë turist i rastit. Çështja u arkivua shumë më shpejt nga ç'ndodhi. Mercedesi me të cilin udhëtonte Sajmira Muzaka kishte dalë nga rruga dhe, mbasi kishte bërë disa rrotullime rreth vetes kishte përfunduar në kanal. «Beh», u shpreh një prej policëve, një farë Melan Bime, i cili vinte nga Qyteti i Madh. «Në qoftë se ajo nuk do të kishte qenë duke pirë duhan atë moment, ndoshta (por me N të madhe ama) mund edhe të kishte shpëtuar. Por ndoshta edhe jo. Ndoshta nafta mund të kishte shkuar gjithsesi tek motori përpara se ajo të mund të zvarritej jashtë makinës.» Por edhe këtë, ashtu si përgjigjen e pyetjes që çdo natë torturonte (e për aq sa mund të imagjinoj vazhdon të torturojë edhe sot) Sotirin, e di vetëm zoti.

«Unë nuk besoj», ishte mendimi i Natashës sime. «Sajmira ishte e destinuar të vdiste, atë ditë.»

Unë kam menduar tjetër gjë. Në fakt, kurrë nuk e kisha parë Sajmirën të pinte duhan, por kjo nuk do të thotë asgjë, natyrisht. As sot e kësaj dite gratë e Drelanit nuk kanë gjetur guximin, apo lirinë e duhur, quajeni si të doni, për të pirë një duhan jashtë mureve të shtëpisë.

Tani, Sotiri është larguar nga Drelani. Katër vite janë bërë pikërisht sot që ai shiti gjithë posedimet e veta në Drelan dhe u nis për në kryeqytet. Një tufë me miq la mbrapa, por edhe një qerre me kujtime.

«Jo, Dalip, jo», më tha përpara se t'i hipte Mercedesit të tij të ri. «Për fatin e keq të njeriut, kujtimet nuk lihen dot në asnjë vend. Do apo s' do ti, ato të ndjekin nga pas si hija, që aty është gjithmonë, pavarësisht nga fakti nëse është diell dhe ti e sheh apo është vrenjtur dhe nuk mundesh.»

Dhe kishte të drejtë: kujtimet mbeten gjithmonë me ne deri në fund. Asgjë nuk humb. Harresa? Kur një kujtim ngatërrohet tej mase dhe zhytet tepër thellë aq sa nuk arrijmë ta kapim dot, vetëm kaq. Por aty është. Në Drelan kanë ndodhur shumë gjëra dhe vazhdojnë të ndodhin. Disa prej tyre, tani, edhe janë zhytur tepër thellë në detin e kujtimeve dhe unë nuk arrij ta mbaj frymën aq sa duhet për t'i arritur e për t'i sjellë në sipërfaqe, por historia e gruas së fotografit, ose më mirë historia e vetë fotografit, ose për të qenë akoma edhe më i saktë, historia e teorisë së rëndësisë së gjërave të vogla të tij, është një histori që ende vazhdon të lundrojë në sipërfaqe dhe përshtypja ime është se kjo gjë do vazhdojë akoma për një kohë të gjatë. Natasha ime kishte të drejtë atë ditë të parë kur i tregova historinë sipas Sotirit. Edhe pse mua nuk më pëlqeu ajo pyetje që më bëri atë natë, mund të them pa frikë se është pikërisht ajo pyetje që bën të mundur lundrimin e kësaj historie në sipërfaqe të detit. Sotir – fotografi, ditën që gruaja e tij shkumbëzohej në Mercedesin e tij, kishte ditën për të shkuar në Tiranë: ishte e martë, atë ditë, ishte dita e larjes së filmave. Unë e Natasha ime kishim disa foto midis atyre filmave. Ajo javë përkonte me 47 vjetorin e njohjes sonë dhe siç e kishim zakon të bënim foto në çdo përvjetor martese, bënim edhe në çdo përvjetor njohjeje.

Fotot i bëmë, por kurrë nuk i morëm ato fotografi dhe di që asnjë drelaniot tjetër nuk ka në shtëpinë e tij qoftë edhe një fotografi të vetme që t'i përkasë javës përpara vdekjes së gruas së fotografit. Natasha ime, herë pas here, më pyet përsëri.

«Të ketë shkuar vërtet në Tiranë, Sotiri, atë ditë?»

Unë ngre supet. Vazhdoj t'i them Natashës sime se, me siguri, ai ka shkuar dhe se gjithë ato foto flenë në ndonjë nga ato kutitë e kartonit që përfunduan, në fillim në bodrumin e shtëpisë së fotografit, mbas varrimit të së shoqes e pastaj, kush e di se ku. Kurse ajo mendon se në fund të atyre kutive – e shumta që mund të gjendet – mund të jenë vetëm *filmat*.

Nuk e di se cili prej nesh ka të drejtë. Sigurisht, mua më pëlqen të besoj se *unë* kam të drejtë, por duke kujtuar tim atë, rahmet pastë! nuk e vë dorën në zjarr.

.....

© Enkelejd Lamaj

*Tiranë / Maj 2006*

Mail: [elamaj@live.com](mailto:elamaj@live.com)

Web: <http://www.tiranacalling.com/>

FB: <http://www.facebook.com/home.php#/pages/Enkelejd-Lamaj/61121164967>